

LIGJ
Nr.9157, datë 4.12.2003

PËR PËRGJIMIN E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

(Ndryshuar me ligjin nr.9885, datë 3.3.2008)

(Ndryshuar me ligjin nr.10 172, datë 22.10.2009)

(Ndryshuar me ligjin nr.116, datë 13.12.2012)

(Ndryshuar me ligjin nr.69, datë 27.4.2017)

I azhurnuar

Ndryshuar titulli me ligjin nr.116, datë 13.12.1012

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

(Shtuar pas fjalëve “për përgjimin” fjala “parandalues” me ligjin nr.69/2017, datë 27.4.2017)

Ky ligj përcakton procedurat që duhet të ndiqen për përgjimin parandalues të komunikimeve elektronike nga institucione shtetërore informative të krijuara me ligj për realizimin e detyrave të tyre, si dhe procedurat që duhet të ndiqen nga personat e ngarkuar për përgjim.

Neni 2

Qëllimi

Ky ligj synon të rrisë efektivitetin e punës së institucioneve shtetërore informative për zbulimin e veprimtarisë antikushtetuese, kriminale dhe keqbërëse, si dhe të parandalojë pasojat që mund të vijnë nga kjo veprimtari.¹

Neni 3

Përkufizime

(Ndryshuar pikat 3 dhe 9 me ligjin nr.116, datë 13.12.1012)

(Ndryshuar fjalë në pikë 1 dhe 2, dhe shtuar pika 10 me ligjin nr.69/2017, datë 27.4.2017)

Në zbatim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

¹ Ligji nr.9157, datë 4.12.2003 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.107, datë 7 janar 2004.
Ligji nr.9885, datë 3.3.2008 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.44, datë 1 prill 2008.
Ligji nr.10 172, datë 22.10.2009 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.154, datë 16 nëntor 2009.
Ligji nr.116/2012, datë 13.12.2012 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.17, datë 2012.
Ligji nr.69/2017, datën 27.4.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.113, datë 22 maj 2017.

1. "Bërthama komanduese elektronike" është pajisja teknike në administrim të Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë së Posaçme, e cila lejon ose ndalon përgjimin e një pajisjeje të komunikimit elektronik.

2. "Objekt përgjimi" janë sinjalet, ose lloj tjetër informacioni, për të marrë ose transmetuar nëpërmjet pajisjeve të komunikimit elektronik.

3. "Sipërmarrës i komunikimeve elektronike" është çdo person fizik ose juridik, i cili ofron rrjete të komunikimeve elektronike dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë.

4. "Pajisje fundore" është çdo pajisje në përdorim nga subjekti i përgjimit që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me një pikë fundore të rrjetit të komunikimeve elektronike për të realizuar komunikimet elektronike.

5. "Pajisje komunikimi elektronik" është çdo mjet teknik (linjë transmetimi, pajisje komutimi dhe çdo pajisje tjetër e nevojshme për të siguruar funksionimin e rrjetit të komunikimeve elektronike) që shërben për realizimin e komunikimeve elektronike.

6. "Përgjim" është ndërhyrja e fshehtë për të kapur, dëgjuar e regjistruar përmbajtjen e komunikimit dhe të dhëna që lidhen me të ndërmjet pikës së nisjes e pikës së mbërritjes.

7. "Situatë emergjente" është situata kur, nga respektimi i kërkesave të këtij ligji për paraqitjen e miratimit e kërkesës me shkrim, dëmtohet rezultati i përgjimit, duke sjellë pasoja të rënda për sigurinë kombëtare.

8. "Subjekt përgjimi" janë personat e dyshuar si autorë krimesh të rënda.

9. "Komunikim" ka të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në pikën 13 të nenit 3 të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

10. "Prokuroria kompetente" është Prokuroria e Përgjithshme ose Prokuroria e Posaçme, sipas kompetencave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Neni 4

Parimet e përgjimit

Parimet bazë për përgjimin e komunikimeve elektronike janë respektimi i lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, nevojshmëria dhe proporcionaliteti, sekreti dhe objektiviteti në kryerjen e tij.

Neni 5

Përdorshmëria e rezultateve të përgjimit

Rezultatet e përgjimit, të marra në bazë të këtij ligji, nuk kanë vlerën e provës në një proces penal, me përjashtim të atyre të marra sipas Kodit të Procedurës Penale.

KREU II

PROCEDURAT PËR KRYERJEN E PËRGJIMIT

Neni 6

Organet që mund të kërkojnë kryerjen e përgjimit

(Shtuar me ligjin nr.10 172, datë 22.10.2009)

(Ndryshuar dhe shtuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr.69/2017, datë 27.4.2017)

1. Shërbimi Informativ Shtetëror, shërbimet informative/policore të ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, të Ministrisë së Mbrojtjes, të Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Drejtësisë, Byroja Kombëtare e Hetimit, si dhe çdo

shërbim tjetër informativ/policor, i krijuar me ligj, kanë të drejtë të kërkojnë përgjimin, për të siguruar të dhënat e domosdoshme për realizimin e detyrave të tyre ligjore.

2. Asnjë prej institucioneve publike të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni nuk ka të drejtë të parashtojë një kërkesë për përgjim për çështje ose veprimtari që nuk janë parashikuar me ligj në objektin e punës e të veprimtarisë së tyre informativo-gjurmuese.

Neni 7

Kërkesa për përgjim

(Shtuar dhe ndryshuar fjalë në pikën 1 dhe 2 me ligjin nr.69/2017, datë 27.4.2017)

1. Kërkesa për përgjim, e paraqitur nga subjektet e parashikuara në nenin 6 të këtij ligji, hartohet në dy kopje, një kopje e së cilës depozitohet pranë Kryetarit të Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar ose, në mungesë të tij, zëvendëskryetarit dhe një e mban vetë institucioni.

2. Kërkesa përmban:

a) institucionin kërkues, emrat dhe funksionet e punonjësve që ndjekin procesin informativo-gjurmues;

b) gjeneralitetet dhe adresën e subjektit në proces informativo-gjurmues ose në ndjekje, si dhe adresën e mjedisit/mjediseve me të cilat lidhet kërkesa për përgjim të komunikimeve elektronike;

c) përshkrimin e komunikimeve elektronike që do të përgjohen dhe kur është e përshtatshme të dhënat për sipërmarrësit e komunikimeve elektronike që i ofron shërbim subjektit që do të përgjohet;

ç) arsyet e përgjimit, si dhe bazën dokumentare ose materialin informativ ku mbështetet kërkesa për përgjim;

d) argumentet që vërtetojnë se përgjimi është i domosdoshëm në situatën e krijuar dhe se të dhënat që kërkohen nuk mund të sigurohen me mjete të tjera;

dh) afatin kohor brenda të cilit kërkohet të bëhet përgjimi.

Neni 8

Dhënia e të drejtës për përgjim

(Shtuar me ligjin nr.10 172, datë 22.10.2009)

(Ndryshuar me ligjin nr.69/2017, datë 27.4.2017)

Kryetari i Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar ose, në mungesë të tij, zëvendëskryetari, pas shqyrtimit të kërkesës me shkrim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, Ministrit të Mbrojtjes, Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Financave, Drejtorit të SHISH-it, Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, si dhe çdo ministrie që ka në varësi shërbime informative/policore të krijuara me ligj, miraton ose refuzon kërkesën për përgjimin e komunikimeve elektronike.

Kërkesa për përgjim shqyrtohet nga gjykata brenda 48 orëve nga momenti i paraqitjes së saj.

Neni 9

Vendimi për përgjim

(Ndryshuar me ligjin nr.69/2017, datë 27.4.2017)

1. Kryetari i Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar ose, në mungesë të tij, zëvendëskryetari merr vendim me shkrim për kërkesën për përgjim, i cili hartohet në tri kopje. Një kopje e vendimit që miraton ose refuzon kërkesën, mbahet në Gjykatën e Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, një kopje e mban institucioni që ka bërë kërkesën dhe kopja e tretë mbahet në bërthamën komanduese

elektronike të prokurorisë kompetente.

2. Kërkesa për përgjim, si dhe gjitha të dhënat e mbledhura nga përgjimi janë konfidenciale. Institucionet e përfshira në procesin e vendimmartjes ruajnë konfidencialitetin për çdo kërkesë dhe të dhënat e mbledhura nga përgjimi, për të cilin kanë dijeni, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ky ligj.

3. Vendimet e përgjimit janë të vlefshme për komunikime elektronike nëpërmjet pajisjeve të telekomunikacionit brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj, kur ka marrëveshje ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë.

Neni 10

Përmbajtja e vendimit për përgjim

(Shtesë në pike "a" me ligjin nr.9885, datë 3.3.2008)

(Ndryshuar me ligjin nr.116, datë 13.12.2012)

(Ndryshuar shkronja "c" me ligjin nr.69/2017, datëm 27.4.2017)

Vendimi për përgjim përmban këto elemente:

a) institucionin kërkues;

b) strukturën përgjegjëse në SHISH, në seksionin e përgjimeve të Policisë së Shtetit apo në Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në ministrinë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, në Byronë Kombëtare të Hetimit ose, sipas rastit, punonjësit e autorizuar nga titullarët e institucioneve kërkuese për të kryer procesin teknik të përgjimit;

c) gjenealitetet dhe adresën e subjektit që do të vendoset nën përgjim, mjedisin/mjediset e identifikuara, për të cilat do të kryhet përgjimi i komunikimeve elektronike, pajisjet fundore të përdorura nga subjekti i përgjimit të komunikimit elektronik, si dhe sipërmarrësin e komunikimeve elektronike që ofron shërbimin;

ç) afatin ose afatet e përgjimit, ku përcaktohet data dhe ora e fillimit dhe e mbarimit. Vendimi ngarkon me zbatimin e tij strukturën përgjegjëse të përgjimeve në SHISH dhe institucionin kërkues.

Neni 11

Ndryshimi i pajisjes fundore

(Ndryshuar me ligjin nr.69/2017, datë 27.4.2017)

Pas marrjes së vendimit për përgjim, kur vihet re se pajisjet fundore të subjektit që përgjohet janë shtuar ose ndryshuar, nuk përsëritet kërkesa për përgjim. Në këtë rast institucioni që ka kërkuar përgjimin është i detyruar të njoftojë me shkrim për pajisjen e re fundore Kryetarin e Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar ose, në mungesë të tij, zëvendëskryetarin, i cili urdhëron bërthamën komanduese përkatëse për ndryshimin ose shtimin e pajisjes apo pajisjeve fundore që përgjohen. Afatet e përgjimit në këtë rast mbeten të pandryshuara.

Neni 12

Struktura Përgjegjëse e Përgjimeve

(Ndryshuar pjesërisht me ligjin nr.9885, datë 3.3.2008)

(Shtuar fjalia e fundit e pikës 1 me ligjin nr.116, datë 13.12.2012)

(Ndryshuar fjalë në pikën 1 dhe 3, dhe shfuqizuar pika 2 me ligjin nr.69/2017, datë 27.4.2017)

1. Struktura Përgjegjëse e Përgjimeve në SHISH realizon vetëm proceset teknike të përgjimit, të komunikimeve elektronike përmes pajisjeve të telekomunikacionit për llogari të institucioneve shtetërore informative, pasi është marrë vendimi për përgjim sipas këtij

ligji. Proceset teknike të përgjimit, për llogari të Policisë së Shtetit dhe të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në ministrinë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, realizohen nëpërmjet seksionit të tyre të përgjimeve, të atashuar në Strukturën Përgjegjëse të Përgjimeve në SHISH. Për llogari të institucioneve të tjera, procesi teknik i përgjimit kryhet nga punonjësit e autorizuar prej tyre.

2. Shfuqizuar.

3. Realizimi i përgjimit nga Struktura Përgjegjëse e Përgjimeve në SHISH dhe seksioni i përgjimeve të Policisë së Shtetit dhe të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në ministrinë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, si dhe nga Byroja Kombëtare e Hetimit, bëhet nëpërmjet sistemeve të instaluar për këtë qëllim. Sistemi i përgjimit kurdoherë duhet të jetë i përbërë nga dy pjesë, të cilat nuk mund të funksionojnë në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra.

Neni 13

Bërthama komanduese elektronike

(Ndryshuar pjesërisht me ligjin nr.9885, datë 3.3.2008)

(Shtuar fjalët “dhe e instaluar”, pas fjalës “në administrim” me ligjin nr.116, datë 13.12.2012)

(Ndryshuar me ligjin nr.69/2017, datë 27.4.2017)

Bërthama komanduese elektronike është pajisje teknike në administrim dhe e instaluar pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë së Posaçme, e cila lejon ose ndalon përgjimin e një pajisjeje fundore. Punonjësi i bërthamës komanduese elektronike, pas vendimit me shkrim për miratimin e kërkesës për përgjim të Kryetarit të Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar ose, në mungesë të tij, të zëvendëskryetarit, mundëson teknikisht procesin e përgjimit nga sektori i përgjimit në SHISH, seksioni i përgjimeve të Policisë së Shtetit, Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në ministrinë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike dhe nga Byroja Kombëtare e Hetimit, me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj parashikohet ndryshe.

Punonjësi i bërthamës komanduese elektronike, me përfundimin e afatit, sipas vendimit të Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, ndërpret automatikisht përgjimin, me përjashtim të rastit kur ka kërkesë për zgjatje afati.

Neni 14

Kohëzgjatja e vendimit të përgjimit

(Ndryshuar me ligjin nr.69/2017, datë 27.4.2017)

1. Të gjitha vendimet për përgjimin e komunikimeve elektronike janë të vlefshme për një periudhë deri në tre muaj.

2. Për çdo zgjatje të këtij afati, institucioni shtetëror përkatës i paraqet Kryetarit të Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar ose, në mungesë të tij, zëvendëskryetarit, një kërkesë me shkrim dhe të arsyetuar së bashku me materialin e deriatëhershëm të zbardhur. Kryetari ose zëvendëskryetari, sipas këtij neni, mund të kërkojë shpjegime ose arsye shtesë për zgjatjen e afatit.

3. Çdo zgjatje afati nuk mund të jetë më tepër se tre muaj.

Neni 15

Njohja me rezultatet e përgjimit

(Ndryshuar me ligjin nr.69/2017, datë 27.4.2017)

1. Drejtuesi i institucionit shtetëror që ka kërkuar përgjimin, njihet me rezultatet e përgjimit, si gjatë afatit të përgjimit, ashtu edhe pas përfundimit të tij.

2. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, Prokurori i Përgjithshëm ose drejtuesi i prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë, sipas kompetencave të tyre, kanë të drejtë të njihen, nga drejtuesi i institucionit shtetëror që ka kërkuar përgjimin, me rezultatet e përgjimit, pas përfundimit të tij, me përjashtim të rasteve kur drejtuesi i institucionit shtetëror përkatës çmon se duhet të njihen me rezultatet e përgjimit edhe para përfundimit të tij.

Neni 16

Kufizimet në përgjim

(Ndryshuar fjalë me ligjin nr.69/2017, datë 27.4.2017)

1. Personave të ngarkuar me funksionin apo detyra të caktuara në ose për procesin e përgjimit në tërësi apo në veçanti u ndalohet:

a) të përhapin ose të përdorin jashtë kërkesave të këtij ligji apo të ligjeve në fuqi të dhënat e grumbulluara;

b) të përgjojnë pa autorizim ose jashtë procedurave të parashikuara nga ky ligj.

2. Procesi i përgjimit, në tërësi ose në veçanti, përbën sekret shtetëror, shkelja e të cilit dënohet sipas legjislacionit penal në fuqi.

Neni 17

Situatat emergjente

(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr.9885, datë 3.3.2008)

(Ndryshuar pika 1 dhe 2 me ligjin nr.69/2017, datë 27.4.2017)

1. Për situata emergjente, me kërkesë verbale të drejtuesit të institucionit shtetëror përkatës, sipas nenit 6, të ligjit, Kryetari i Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar ose, në mungesë të tij, zëvendëskryetari urdhëron me shkrim realizimin teknik të procesit të përgjimit. Urdhri i gjykatës regjistrohët menjëherë në evidencat e bërthamës komanduese elektronike të prokurorisë kompetente dhe të specialistët e strukturës përgjegjëse të përgjimeve në SHISH ose seksionit të përgjimeve të Policisë së Shtetit, Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në ministrinë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike. Me regjistrimin e urdhrit, specialistët e sektorit të përgjimeve ose të seksionit të përgjimeve të Policisë së Shtetit, Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në ministrinë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike realizojnë procesin e përgjimit.

2. Brenda 8 orëve nga fillimi i përgjimit, institucioni shtetëror që ka bërë kërkesën, i paraqet Kryetarit të Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar ose, në mungesë të tij, zëvendëskryetarit kërkesën e rregullt me shkrim, e cila përmban arsyet e veprimeve emergjente së bashku me komunikimin e përgjuar të zbardhur. Mbi këtë bazë, brenda 24 orëve nga fillimi i përgjimit, merret vendimi për vazhdimin ose ndërprerjen e përgjimit.”

3. Mosparaqitja e kërkesës me shkrim brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, sjell ndërprerjen e menjëhershme të përgjimit.

Neni 18

Revokimi i vendimit të përgjimit

(Ndryshuar me ligjin nr.69/2017, datë 27.4.2017)

Nëse ndodh një ndryshim që çon në përfundimin se përgjimi nuk është më i nevojshëm ose praktik për t’u zbatuar, atëherë, me kërkesë me shkrim të institucionit shtetëror përkatës, drejtuar Kryetarit të Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar ose, në mungesë të tij, zëvendëskryetarit, vendimi revokohet.

Vendimi i revokimit u njoftohet bërthamave komanduese elektronike përkatëse, kërkuesit dhe zbatuesit teknik të përgjimit.”.

KREU III KËRKESA TË VEÇANTA PËR PËRGJIM

Neni 19

Përgjimi me kërkesë të shërbimeve të huaja informative/police

(Ndryshuar me ligjin nr.9885, datë 3.3.2008)

(Ndryshuar fjalë me ligjin nr.69/2017, datë 27.4.2017)

Me kërkesë të shërbimeve të huaja informative/police dhe me miratimin e Kryetarit të Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar ose, në mungesë të tij, të zëvendëskryetarit, Struktura Përgjegjëse e Përgjimeve në SHISH ose seksioni i përgjimeve të Policisë së Shtetit dhe të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në ministrinë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, apo Byroja Kombëtare e Hetimit mund të realizojë, sipas rastit, përgjimin, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, për llogari të shërbimit informativ/police të huaj.

Neni 20

Asgjësimi dhe ruajtja e materialit të përgjimit

(Ndryshuar pika 3 me ligjin nr.9885, datë 3.3.2008)

(Në pikën 3 pas emërimit “Ministri i Brendshëm” shtohet emërtimi “Ministri i Drejtësisë”, me ligjin nr.116, datë 13.12.2012)

(Ndryshuar me ligjin nr.69/2017, datë 27.4.2017)

1. Materiali i përfituar nga procesi i përgjimit parandalues të komunikimit elektronik asgjësohet brenda 10 ditëve nga përfundimi i afatit të përgjimit. Materiali i përgjimit ruhet vetëm në rast se ka premisa të bëhet i rëndësishëm për ruajtjen e jetës, sigurinë kombëtare, rendin publik ose parandalimin e krimeve të rënda.

2. Drejtuesi i institucionit shtetëror përkatës, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit të përgjimit, i drejton kërkesë me shkrim Kryetarit të Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar ose, në mungesë të tij, zëvendëskryetarit, për ruajtjen e materialit të përgjimit. Kryetari i Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar ose, në mungesë të tij, zëvendëskryetari vendos për pranimin ose refuzimin e kërkesës brenda 72 orëve nga paraqitja e saj.

3. Në rast se kërkesa refuzohet, materiali i përgjimit asgjësohet brenda afatit të përmendur në pikën 1, të këtij neni, sipas procedurave të përcaktuara në udhëzimin e përbashkët të Prokurorit të Përgjithshëm, Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, Ministrit të Mbrojtjes, Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Financave dhe Drejtorit të SHISH-it.

4. Në rast se kërkesa për ruajtjen e materialit pranohet, në vendim përcaktohet dhe koha e nevojshme për ruajtjen e tij. Me përfundimin e afatit të caktuar në vendim, materiali i ruajtur asgjësohet sipas afatit dhe procedurave të parashikuara në këtë nen.”.

Neni 20/1

E drejta për informim

(Shtuar me ligjin nr.69/2017, datë 27.4.2017)

1. Institucioni shtetëror kompetent, brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës me shkrim të një qytetari, duhet ta informojë nëse ndaj tij është kryer përgjimi i komunikimeve elektronike. Ky informacion jepet vetëm pas përfundimit të përgjimit.

2. Qytetari ka të drejtë të kërkojë dokumente mbi të dhënat e mbledhura, të cilat mund t'i vihen në dispozicion, pa emrin e punonjësit, i cili i ka mbledhur, si dhe pa të dhënat mbi burimet e informacionit të agjencive të sigurisë dhe inteligjencës dhe palëve të treta.

3. Institucioni shtetëror kompetent nuk është i detyruar të veprojë sipas parashikimit të pikës 1, të këtij neni, nëse:

- a) njoftimi mund të rrezikojë zbatimin e detyrave të institucionit;
- b) informacioni mund të çojë në cenimin e sigurisë së një personi tjetër;
- c) përmbajtja e komunikimit të përgjuar përbën sekret shtetëror dhe mund të çojë në pasoja të dëmshme për sigurinë ose interesat kombëtarë.

KREU IV SIPËRMARRËSIT E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

Neni 21

Aftësitë përgjuese të rrjeteve të komunikimeve elektronike

(Ndryshuar pikat 1 dhe 4 dhe shtohen pikat 5 dhe 6 me ligjin nr.116, datë 13.12.2012)

(Ndryshuar fjalë në fund të pikës 2 me ligjin nr.69/2017, datë 27.4.2017)

1. Sipërmarrësit e komunikimeve elektronike realizojnë, me shpenzimet e tyre, infrastrukturën e nevojshme në rrjetin e tyre të komunikimeve elektronike, deri në pikën e lidhjes me bërthamën elektronike të komandimit, për të siguruar, brenda 180 ditëve nga marrja e kërkesës nga institucionet që administrojnë sisteme përgjimi, sipas këtij ligji, aftësinë përgjuese ndaj përdoruesve që shfrytëzojnë shërbimet e komunikimeve elektronike të ofruara prej tyre.

2. Infrastruktura që realizohet nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike për të siguruar aftësinë përgjuese duhet të jetë në përputhje teknologjike me pajisjet e bërthamave komanduese elektronike të sistemeve të përgjimit.

3. Sipërmarrësit e komunikimeve elektronike janë të detyruar të ofrojnë pa pagesë çdo shërbim në funksion të procesit të përgjimit.

4. Kur sipërmarrësit e komunikimeve elektronike bëjnë çdo lloj ndryshimi teknologjik ose zgjerim kapaciteti, detyrohen të mbulojnë me shpenzimet e veta vazhdueshmërinë e funksionimit të procesit të përgjimit.

5. Në rast ndryshimesh në bërthamën elektronike të komandimit, që imponojnë ndryshime në infrastrukturën e komunikimeve elektronike të sipërmarrësve, struktura përgjegjëse për bërthamën elektronike të komandimit njofton sipërmarrësit e komunikimeve elektronike për ndryshimin, të paktën, 180 ditë para këtij ndryshimi.

6. Në rast të mospërmbushjes së detyrimit, sipas pikës 1 të këtij neni, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare vepron në përputhje me kompetencat e parashikuara në nenet 18, 131 dhe 137 të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Neni 22

Asistenca e ofruar nga operatorët e komunikimeve elektronike

(Ndryshuar pjesërisht pika 1 me ligjin nr.9885, datë 3.3.2008)

(Ndryshuar titulli, ndryshuar fjalë në pikën 1 dhe 2 me ligjin nr.69/2017, datë 27.4.2017)

1. Kur përgjimi nuk mund të realizohet nëpërmjet sistemit të përgjimit, Drejtori i SHISH-it, ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike ose Ministri i Drejtësisë, sipas rastit, kërkon ndihmën e çdo sipërmarrësi të komunikimeve elektronike në

Republikën e Shqipërisë dhe sipërmarrësit janë të detyruar të ndërmarrin hapat e nevojshëm.

2. Në këto raste sipërmarrësit i jepet kopje e vendimit të Kryetarit të Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar ose, në mungesë të tij, të zëvendëskryetarit, me përmbajtje të shkurtuar dhe pa të dhëna që mund të dëmtojnë procesin informativo-gjurmues. Kjo kopje duhet të përmbajë afatin kohor për gjetjen nga sipërmarrësi të numrave, adresave ose faktorëve të tjerë që duhen identifikuar për përgjimin. Kur është e nevojshme, kopja e vendimit shoqërohet edhe me një dokument shtesë, ku përcaktohen hollësitë e tjera teknike për pajisjet e komunikimeve elektronike.

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 23

Përgjimet me vendim gjykatë

(Ndryshuar me ligjin nr.9885, datë 3.3.2008)

(Ndryshuar me ligjin nr.69/2017, datë 27.4.2017)

1. Proceset teknike të përgjimit të komunikimeve elektronike, nëpërmjet pajisjeve të telekomunikacionit, për nevoja të hetimeve paraprake, kryhen sipas parashikimeve të neneve 221 - 226 të Kodit të Procedurës Penale.

2. Prokurori i prokurorisë kompetente, me akt zyrtar, bashkëshoqëron dhe komunikon vendimin e gjykatës në strukturën e përgjimeve elektronike pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë së Posaçme, sipas kompetencës së tyre.

3. Procesi teknik i dëgjimit dhe transkriptimit mund të kryhet edhe në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm dhe në Prokurorinë e Posaçme, sipas kompetencave të tyre.

Neni 24

Nxjerrja e akteve nënligjore

(Ndryshuar pjesërisht me ligjin nr.9885, datë 3.3.2008)

(Ndryshuar pjesërisht me ligjin nr.116, datë 13.12.2012)

(Ndryshuar me ligjin nr. 69/2017, datë 27.4.2017)

Prokurori i Përgjithshëm, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Drejtësisë, Ministri i Financave, Drejtori i SHISH-it dhe Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit, brenda 3 muajve nga krijimi i Prokurorisë së Posaçme, nxjerrin një udhëzim të përbashkët për:

a) mënyrën e detajuar të realizimit të proceseve të përgjimit, sipas kërkesave të neneve 6, 10, 13, 14 dhe 15 të këtij ligji;

b) rregullat për ruajtjen e sekretit dhe të dokumentacionit të dalë nga procesi i përgjimit, sipas neneve 16 dhe 20 të këtij ligji;

c) mënyrën e ruajtjes dhe asgjësimit të materialit të përgjimit, sipas nenit 20 të këtij ligji.

Neni 25

Shfuqizime

Çdo dispozitë që bie në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohet.

Dispozitë kalimtare

(Vendosur me ligjin nr.69/2017, datë 27.4.2017)

1. Brenda gjashtë muajve nga krijimi i Prokurorisë së Posaçme, në mjediset e kësaj prokurorie instalohen pajisjet që bëjnë të mundur proceset teknike të përgjimit, sipas këtij ligji.

2. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme njofton për datën e fillimit të funksionimit të bërthamës komanduese elektronike Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe të gjitha organet që kryejnë përgjimin e komunikimeve elektronike, sipas këtij ligji.

3. Brenda 10 ditëve nga fillimi i funksionimit të bërthamës komanduese elektronike, çdo përgjim i autorizuar dhe që është duke u kryer në Prokurorinë e Përgjithshme, për veprat penale nën juridiksionin e Prokurorisë së Posaçme, transferohet në këtë prokurori. Çdo material tjetër përgjimi, për çështjet që janë në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme, transferohet, me kërkesë, pranë kësaj prokurorie, përveç rasteve kur materiali është asgjësuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

4. Deri në fillimin e funksionimit të bërthamës komanduese elektronike pranë Prokurorisë së Posaçme, kompetencat e saj për përgjimin parandalues të komunikimeve elektronike ushtrohen nga Prokuroria e Përgjithshme.

5. Deri në fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, miratimi ose refuzimi i kërkesës për përgjimin e komunikimeve elektronike do të vazhdojë të kryhet nga Prokurori i Përgjithshëm ose, në mungesë të tij, nga prokurori i autorizuar prej tij.

Neni 26 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4053, datë 28.12.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu